

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kim Jong-un kërkon më shumë armë me “inteligjencë artificiale”, rritet prodhimi ushtarak në Korenë e Veriut
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/bota/kim-jong-un-kerkon-me-shume-arme-me-inteligjence-artificiale-rr-i1185446
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 07:50:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 07:45:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	317d4cce1a64eb42ca884798f1a346236868065d725a99fb2ed7f3bfc33f4740
TEKSTI	324aa0d18d22b12ded2eeb946a822cfcbac3cfd3bcdcd18d664992f9575482fa
PAMJA	49f466f80392f30e0d9fb779e482a4b83737da74ee1f9b7a0fa42626ae6cfd23

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0cccd980e2682312253bd70d6d6b7aa8fd6451f125f19ad427bff8887587ae0c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b7b490a69c70e21e2941949443c05c93b4bd86b11849ed3235586ee33bac8ed0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0cccd980e2682312253bd70d6d6b7aa8fd6451f125f19ad427bff8887587ae0c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kim Jong-un kërkon më shumë armë me “inteligjencë artificiale”, rritet prodhimi ushtarak në Korenë e Veriut

Nga A2 CNN
20 Shtator 2026, 09:45 | Bota



Udhëheqësi i Koresë së Veriut, Kim Jong-un, ka bërë thirrje për përdorimin më të gjerë të inteligjencës artificiale dhe automatizimit në armët sulmuese dhe mbrojtëse të vendit, ndërsa u ka kërkuar prodhuesve të rrisin prodhimin.

Kim i bëri këto deklarata gjatë inspektimit të disa ndërmarrjeve të mbrojtjes, nga e mërkura deri të premten, i shoqëruar nga zyrtarë të lartë dhe motra e tij me ndikim, Kim Yo-jong.

Fotot e publikuara nga mediat shtetërore e tregojnë atë gjatë vizitave në uzina që prodhojnë dronë dhe sisteme artilerie, përfshirë sistemet masive të raketavehëdhësve shumëfish të 600 mm (MLRS).

I njohur jashtë Koresë së Veriut si KN-25, ky sistem ngjan me HIMARS-in e prodhuar në SHBA, por është zhvilluar përtëj një sistemi konvencional raketashëdhës shumëfish të, duke funksionuar në praktikë si një lëshues raketash balistike me rreze të shkurtër veprimi.

“Artileria jonë duhet të ketë kapacitet sulmues sa më të përqendruar, shkatërrues, masiv dhe të gjithanshëm, si dhe të përmbushë me përgjegjësi dy misionet e saj: parandalimin e luftës dhe zhvillimin e saj”, deklaroi udhëheqësi i Koresë së Veriut, sipas agjencisë KCNA.

Kim bëri gjithashtu thirrje për përdorim më të gjerë të inteligjencës artificiale në “sistemet e armëve luftake sulmuese dhe mbrojtëse”, si dhe për përmirësimin e blindimit dhe automatizimit të armatimit të artilerisë, raportuan mediat shtetërore. Ai udhëzoi gjithashtu fabrikat prodhuese të rrisin prodhimin dhe të përmirësojnë “kushtet dhe mjedisin e prodhimit”.

Sipas raportimeve, lideri i Koresë së Veriut “shprehu kënaqësi të madhe”, pasi konstatoi se shumica e fabrikave po përmbushin objektivat e prodhimit për të realizuar “planet e mëdha” të përcaktuara nga Komisioni Qendror Ushtarak i Partisë, organi më i lartë i vendit për çështjet dhe planifikimin ushtarak.

Përpara se t'i bashkohej klubit të vendeve me armë bërthamore në mesin e viteve 2000, Koreja e Veriut mbështetej në një arsenal të gjerë artilerie për parandalim, pasi kryeqyteti i Koresë së Jugut, Seuli, ndodhet brenda rrezes së artilerisë konvencionale.

Pheniani ka punuar së fundmi për modernizimin dhe zgjerimin e arsenalit të tij të artilerisë, ndërsa disa prej sistemeve raketore në arsenalin e tij mund të përdoren gjithashtu për transportimin dhe lëshimin e armëve bërthamore.

TE FUNDIT

Tirana International Film Festival, 230 filma nga 70 vende të botës në konkurrim në TIFF

Armët dhe përkrenarja e Skënderbeut, peticion për t'i rikthyer në Shqipëri pas 433 vitesh në Muzeun e Vjenës

Dinamo arrin fitoren e katërt radhazi

A mund të zhbëhet Gjykata Speciale? Juristi nga Londra: Do të duhet mbështetje ndërkombëtare

MË TË VIZITUARAT

Ukshini: Gjykata Speciale u ngrit për të dënua shqiptarët

Ish-luftëtari i UÇK-së: Haga na dënoi si komb, ka implikuar një Shqipëri të t...

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, gazetarja: Gjykatësi e ka personale, që kur p...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

(A2 Television)

A2 CNN **Livestream**

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



“Siguroni ushqime dhe strehim”, SHBA alarm për luftë, Trump kthehet herët nga Camp David



Sulmi i Huthit, Turqia gati t'i japë ndihmë ushtarake Arabisë Saudite: E papranueshme përfshirja në luftën SHBA-Iran



Huthët sulmojnë me dronë dhe raketa Riadin, Arabia Saudite aktivizon mbrojtjen ajrore, reagon DASH



Putini mbledh gjeneralët: Europa po bëhet gati për një luftë me ne



Zbulimi shokues në Amerikë, raporti “Flas me AI” gati sa nuk shkaktoi luftën SHBA-Kinë



Aneksim jo, mbrojtje me ushtri, çfarë parashikon marrëveshja SHBA-Danimarkë për Groenlandën


Latest Videos

VIDEO



VIDEO





"Siguroni ushqime dhe strehim", SHBA alarm për luftë, Trump kthehet herët nga Camp David



Tirana International Film Festival, 230 filma nga 70 vende të botës në konkurrim në TIFF



Armët dhe përkrenarja e Skënderbeut, petition për t'i rikthyer në Shqipëri pas 433 vitesh në Vjenë



Rama nuk tërhiqet, shkrin 15 bashki, Berisha urdhër strukturave për seleksionimin e kandidatëve

Shqipëria Aktualitet Kronikë Politikë Ekonomi Sociale Kulturë Moti	Kosova Kulturë Sociale Ekonomi Politikë Kronikë Aktualitet	Rajoni & Bota Balkani Bota	Argëtim Showbiz Lifestyle Kapur në kamera Teknologji	Sport Live Euro 2024 Futboll Sporte të tjera	Speciale A2 5 gjëra në 5 minuta A2 CNN në Izrael 31 Minuta A2 CNN në Ukrainë Lumi i kokainës Ditari ndërkombëtar Zbulio Imagjinatë Dëshmi	f t i y
--	---	---	---	--	---	---

Live TV

[Rreth nesh](#)
[Kushtet e Privatësisë](#)
[Karriera](#)
[Kontakt](#)

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
 All Rights Reserved.

Mundësuar nga Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.